

Prishtinë: 01/11/2007
Kodi i ZRRE: D_067_2007

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji, duke u bazuar në:

1. Nenin 26 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë,
2. Nenin 28.7 të Kushteve të Përgjithshme për Furnizim me Energji,
3. Nenin 14 të Licencës së Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes,
4. Kërkesën e Korporatës Energjetike të Kosovës Sh.A.(tani e tutje KEK) për miratimin e Procedurës së përkohshme për Identifikimin dhe Parandalimin e Konsumimit të Paautorizuar të Energjisë Elektrike dhe Procedurës së përkohshme të faturimit dhe leximit të konsumatorëve shtëpiak.

Në seancën e mbajtur më 01 nëntor 2007 nxjerrë këtë:

VENDIM

- I. Miratohet Procedura e përkohshme për identifikimin dhe parandalimin e konsumimit të paautorizuar të energjisë elektrike.**
- II. Miratohet Procedura e përkohshme për faturimin dhe leximin e konsumatorëve shtëpiak.**
- III. Procedurat do të zbatohen deri me 31 dhjetor 2008.**

1. Në shtator 2007 KEK-u ka ushtruar kërkesën për miratimin e Procedurës për identifikimin dhe parandalimin e konsumimit të paautorizuar të energjisë elektrike si dhe Procedurës së për faturimin dhe leximin e konsumatorëve shtëpiak.
2. Pas vlerësimit të kërkesës dhe shqyrtimit dhe plotësimit të dokumenteve të bashkangjitura, ZRRE ka vendosur të miratojë dokumentet si në dispozitiv të këtij vendimi si të Përkohshme deri në nxjerrjen e atyre të një të qëndrueshme të një për kohëzgjatje më të madhe me veprim nga 1 janari 2009.
3. Pas marrjes së njoftimit nga ZRRE-ja apo publikimit të vendimit në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së, KEK do t'i publikojë në faqen e vet elektronike Procedurat e miratuara.
4. Ky Vendim nxirret në tri gjuhë: shqip, serbisht dhe anglisht. Në rast të mospërputhjes midis versioneve të ndryshme, do të mbizotërojnë versioni në gjuhën shqipe.
5. Palët e pakënaqura mund të paraqesin ankesë kundër këtij vendimi në gjykatën e juridiksionit përkatës, brenda 14 ditësh nga data e miratimit ose datës së publikimit të vendimit në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

6. Ky vendim hyn në fuqi me datën e miratimit nga ana e Bordit të ZRRE-së.

Bashkangjitur: Versionet e miratuara të:

-Procedurës e përkohshme për Identifikimin dhe Parandalimin e Konsumimit të Paaautorizuar të Energjisë Elektrike të KEK Sh.A.

-Procedura e përkohshme për faturimin dhe leximin e konsumatorëve shtëpiak.

Bordi i ZRRE:

Ali Hamiti, Kryesues

Theranda Beqiri, Anëtare

Naim Bejtullahu, Anëtar

Nysret Avdiu, Anëtar